

## Njoftim për Shtyp

### **Zhvillohet mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë**

Në institucionin e Avokatit të Popullit, ditën e martë, datë 03.10.2023, ora 16.00 u zhvillua mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë.

Në prezencë të të gjithë anëtarëve dhe në përputhje me rendin e ditës, Komisioni i Pavarur Ad-Hoc vazhdoi procesin e verifikimit paraprak të plotësimit të kushteve ligjore për gjashtë kandidatë të tjerë.

Pas shqyrtimit dhe diskutimeve të zhvilluara në lidhje me disa elementë kryesorë të vlerësimit të kriterëve ligjore dhe çështjeve specifike që kërkojnë një vendimmarrje, Komisioni konstatoi mospërmbushjen e plotësimit të kriterëve ligjore nga tre prej kandidatëve, ndërkohë që për kandidatët e tjerë do të vijojë hetimi administrativ. Gjithashtu, Komisioni vendosi marrjen e informacionit të hollësishëm në lidhje me shlyerjen e rregullt të detyrimeve tatimore nga kandidatët për të tërë ata kandidatë që nuk kanë sjellë dokument për plotësimin e këtij kriteri.

Më pas, Komisioni zhvilloi një takim me ekspertin ndërkombëtar Dr. Charles Ericksen nga East-West Management Institute, ku u diskutua mbi metodologjinë e intervistimit të kandidatëve dhe në përfundim të takimit eksperti dorëzoi një udhëzues mbi mënyrën e intervistimit.

Komisioni vendosi që mbledhjet e rradhës të zhvillohet në datat 12 tetor 2023, ora 15.00, dhe 13 tetor 2023, ora 14.00, në ambientet e institucionit të Avokatit të Popullit, ku do të vazhdohet me shqyrtimin e verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore nga kandidatët.